

VENDIM
Nr.2, datë 6.1.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË PLANIN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT TË
MINISTRISË SË NDËRTIMIT, STREHIMIT DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT PËR
VITIN 1992, PËR T'U ARDHUR NË NDIHMË ZONAVE TË PËRMBYTURA

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Për t'u ardhur në ndihmë zonave të përmbytura, nga fondet buxhetore të pa përdorura nga ministritë dhe institucionet qendrore që rezultojnë me mbylljen e vitit 1992, Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, i shtohen 200 milionë lekë shpenzime në planin e buxhetit të vitit 1992.

2. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi